

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA RAHOVEC-DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Burim Krasniqi nga fshati Xërxë, për shkak të kundërvajtjes nga neni 5,6 paragrafi 1.3 dhe neni 9 të Ligjit nr.04/L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, dhe në bazë të nenit 195 dhe 199, të Ligjit mbi kundërvajtjet, më 01.10.2013, mori këtë

A K T V E N D I M

I PANDEHURI: Burim Skender Krasniqi, i lindur më 06.07.1980, në fshatin Xërxë, komuna e Rahovecit, ku dhe tani jeton, Shqiptar, shtetas Kosovar, i punësuar, i gjendjes së mesme ekonomike, gjer me tani i pa denuar,

Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S

Sepse deri më datën 31.03.2012, nuk ka përmbushur obligimin ligjor për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë, por formular për deklarimin e pasurisë e ka dorëzuar më 04.04.2012.

Me veprime të kështilla ka kryer kundërvajtjen nga neni 9 e sanksionuar sipas nenit 17 të Ligjit Nr.04/L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin dhe prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, por gjykata duke aplikuar nenin 10 të LMK-së, i shqiptohet

Q O R T I M I


Me bindje se edhe me këtë masë do të arrihet qëllimi i dënimit.
I pandehuri lirohet nga paushalli gjyqësor, konform nenit 113 të Ligjit mbi kundërvajtjet.

A r s y e t i m

Në baze të kërkeses së Agjencionit Kundër Korrupsionit në Prishtinë, me nr.01-2531/12, të datës 13.07.2012, është inicuar procedura kundërvajtëse kundër të pandehurit, për shkak të kundërvajtjes të përshkruar si në hyrje të këtij aktvendimi.

Gjatë procedurës i pandehuri është marrur në pyetje i cili në mbrojtjen e vet deklaroi se shënimet në kërkesë janë përsëritshme të vërteta duke shtuar se është e vërtetë nse deklarimin e pasurisë e ka bërë më 04.04.2012, duke i prezentu gjykatës formularin për deklarimin e pasurisë për vitin 2012, duke shtuar se përmes imel adresës ka kontaktuar me zyrtarin Enis Sadikun lidhur me formularin për deklarimin e pasurisë me mesazh, se në asamble koimunale janë njoftuar, mirëpo nuk është cekur afati i fundit, dhe këtë vonesë e kam bërë duke menduar se ka ende kohë, e jo si pasojë e neglizhencës, apo diçka të ngajshme, zyrtari Enis Sadiku ka pranuar formularin për deklarimin e pasurisë, duke kërkuar që ti bashkangjies faqen e tretë, dhe klam mare konfirmimin se çdo gjë është në rregull, duke shtuar se nuk i ka dorëzuar vetëm faqja e tretë, dhe menjëherë kam vepruar, duke i prezentu gjykatës imelat me zyrtarin ligjor të kundërkorrupsionit, më pastaj në veb faqen e internetit të Agjencionit Kundër Korrupsionit figuron se e ka deklaruar pasurin për vitin 2012. I pandehuri në fjalën e vet të fundit kërkoi nga gjykata të ketë parasysh të gjitha këto për vonesat dhe sipas zyrtarëve të Agjencionit mendon se ka kryer deklarimin me kohë.


Gjykata pas administrimit të provave, kërkeses së organit për iniciimin e procedurës, deklarates e të pandehurit, dhe në baze të provave të tjera të shkresave të lëndës ka konstatuar se i pandehuri me të vertet ka kryer kundërvajtje të mosdeklarimit të pasurisë duke u vonuar, por nga provat në shkresat e lëndës dhe nga të dhënat në veb faqen të Agjencionit del se i pandehuri me kohë nuk i ka dëruar formularin por këtë e ka bërë me vonesë pikërisht më datën 04.04.2012 kur dhe i është dorëzuar Agjencionit Kundër Korrupsionit, andaj gjykata gjeti se nuk janë shaktuar pasojat nga vepra kundërvajtëse me deklarimin e pasurisë për 3 ditë, të cilën i pandehuri menjëherë e ka evituar, dhe me përgjegjësit të Agjencionit ka kontaktuar dhe vonesat, dhe mu për këtë ia shqiptoi masen e QORTIMIT duke menduar se dhe me këtë masë do të arrihet qëllimi dhe se i pandehuri në të ardhmen nuk do të kryerj keso kundërvajtje, dhe duke aplikuar nenin 10 të LMK-se i shqiptoi masen e Qortimit si në dispozitiv.



Me rastin e shqiptimit të këtij dënimi-mase janë marrë parasyshtë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato se nuk janë shkaktuar pasojat, ka evituar menjëherë Gabimin dhe i pandehuri deri më tani asnjherë nuk kundërvajfje të kësaj natyre apo të ngjajshmei dhe ato rënduese e krejt konform dispozitave të nenit 7 të Ligjit mbi kundërvajtjet.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor u muar ne baze te nenit 113 të LMK-se.

Me sa u tha mbi e sipër është vendosur si ne dispozitiv te ketij aktvendimi.
GJYKATA THEM, ELORE GJAKOVË-DEGA RAHOVEC
Regj. I nr.04-317/2012 të datës 01.10.2013.



UDHEZIMI JURIDIK: Kunder ketij aktvendimi mund te ushtrohet ankese ne afat prej 8 diteve nga dita e pranimit te aktvendimit Gjykates se Apelit tje ne Prishtine, nepermjet kesaj gjykate.